



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:004526  
Datë: 04.09.2024  
Numri i dokumentit: 06119709

C-IV-14-6867

*Ankuesja*

A Z. Viti.

*Kundër*

*Pala kundërshtare*

Agjencia Kosovare e Privatizimit – AKP (NSH "Agromorava" në likuidim), Rr. "Dritan Hoxha" nr. 55, Lakërishte, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), gjyqtarja Ganimete Puka, me 04.shtator. 2024, lëshon këtë:

**A K T V E N D I M**

- Ankesa konsiderohet e tërhequr.**
- Secila palë i bartë shpenzimet veta procedurale.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 31 tetor 2014, pranë DHPGJS, ankuesja parashtrij kërkesë me të cilën kërkohet kompensim për tri paga në shumë prej 1,050.00 Euro, ndaj NSH – "Agromorava" (në likuidim), me të cilën AKP ka refuzuar kërkesën e saj si të pavlefshme.

Me 25 qershor 2024, gjykata lëshoj një vërejtje për ankuesen mbi pagesën e taksës gjyqësore. Me të njëjtën vërejtje ankuesja u informua se nëse taksat nuk paguhen brenda periudhës së caktuar prej 15 ditësh, ankesa do të konsiderohet e tërhequr.

Vërejtja, e lartë cekur, i është dorëzuar ankueses me 01 korrik 2024.

Gjer me datën e lëshimit të këtij vendimi taksat gjyqësore nuk janë paguar.

## **Arsyetimi ligjor**

Ankesa konsiderohet e tërhequr.

Neni 76.3 i Ligjit Nr.06-L-086 për DHPGJS (Ligji nr. 06/L-086) parasheh: *Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.*

Ankuesja komfor dispozitës së nenit 253.4 të LPK-së ka për detyrë që ankesës t'ia bashkëngjis vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar.

Ne vazhdim dispozita 253.5 parasheh: *Në qoftë se paditësi/ja nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.*

Me 25 qershor 2024, gjykata përmes vërejtjes kërkoj nga ankuesja, që të bëj pagesën e taksës gjyqësore, duke e njoftuar se ankesa e saj do të konsiderohet e tërhequr nëse ajo nuk e paguan taksën gjyqësore.

Ankueses i është lejuar afati prej 15 ditësh që ta bëj pagesën e taksës gjyqësore. Sipas vlerësimit të gjykatës, ky është një afat i mjaftueshëm kohor.

Ankuesja ka për obligim ti paguaj taksat gjyqësore. Taksat gjyqësore aplikohen sipas nenit 63 të Ligjit të DHPGJS-së në lidhje me udhëzimin e KGJK-së Nr. 01/2017, lidhur me taksat gjyqësore.

Nga kjo gjykata konsideron se ankuesja nuk ka interes për çështjen juridike të tij dhe se në rastin konkret sipas dispozitave ligjore ankesa konsiderohet e tërhequr.

Gjykata nga gjitha arsyet e lartcekura nuk ndërmori veprime të mëtutjeshme procedurale si dhe nuk hyri në shqyrtim të çështjes.

## **Shpenzimet Gjyqësore**

Në pajtim me nenin 62 të Ligjit për DHPGJS, secila palë i bartë shpenzimet e veta.

## **Këshillë juridike**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrahet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për DHPGJS.

Ganimete Puka,

---

**G j y q t a r e**